



**Prishtinë, 30 shtator 2011**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_378\_2011**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 paragrafi 2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 49 paragrafi 2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) për derogim të disa neneve të Licencës për Gjenerim TC Kosova A, TC Kosova B, Shpërndarje, Furnizim Publik dhe Furnizim/Tregti me energji elektrike, të datës 11.07.2011,

**në seancën e mbajtur me datë 30 shtator 2011, nxori këtë:**

## **VENDIM**

**I. I LEJOHET** KEK Sh.A derogimi (sipas Shtojcës së bashkëngjitur), në zbatimin e disa neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova A
- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova B
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike dhe
- Licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

## **Arsyetim**

- ZRRE me datë 11.07.2011 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes KEK Sh. a, e cila ka kërkuar shtyrje afati (derogim) të disa neneve të licencës për Gjenerim TC Kosova A, TC Kosova B, Shpërndarje, Furnizim Publik, dhe Furnizim/Tregti me energji elektrike.
  - Korporata Energjetike e Kosovës, në pamundësi të përmbushjes së kushteve të Licencave ka kërkuar shtyrje afati të disa Neneve të licencave, si në Shtojcë të këtij vendimi.
  - ZRRE ka vlerësuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ndërmarrja KEK Sh.a dhe pas plotësimit të dëshmimeve të kërkuara, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të KEK Sh.a-së mbesin në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

\*Bashkëngjitur Shtojca me derogimet (shtyrje afati) e lejuara.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar



**Shtojcë: Nenet e deroguara (shtyrje afati) me datë 30 shtator 2011 të licencave të KEK SH.A-së**

<b>Licenca e Gjenerimit TC Kosova A</b>									
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Derogimi i datës 30.04.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Derogimi i datës 28.01.11 deri me:	Derogimi i datës 30.08.11 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	31 dhjetor 2011	
2.	Neni 14 - Mjedisi	31 dhjetor 2009	-	30 qershor 2010	-	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2011	-	-
3.	Neni 15- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-	-	-	31 dhjetor 2011	-
<b>Licenca e Gjenerimit TC Kosova B</b>									
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Derogimi i datës 30.04.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Derogimi i datës 28.01.11 deri me:	Derogimi i datës 30.08.11 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara per Bizneset gjeneruese	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	31 dhjetor 2011	
2.	Neni 12 - Mjedisi	31 dhjetor 2009	-	30 qershor 2010	-	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2011	-	-
3.	Neni 15- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-	-	-	31 dhjetor 2011	-
<b>Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes</b>									
Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Derogimi i datës 30.04.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Derogimi i datës 28.01.11 deri me:	Derogimi i datës 30.08.11 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset e Operatorit të Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	31 dhjetor 2011	
2.	Neni 11-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	30 qershor 2010	-	01 nëntor 2010	31 mars 2011	31 dhjetor 2011	-
3.	Neni 12 Standardet e Sigurisë së Operimit	31 dhjetor 2008	30 qershor 2009	30 qershor 2010	-	01 nëntor 2010	31 mars 2011	31 dhjetor 2011	-
5.	Neni 22- Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2009	-	31 dhjetor 2010	-	-	-	31 dhjetor 2011	-



### Licenca për Furnizim Publik me Energji Elektrike

Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Derogimi i datës 30.04.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Derogimi i datës 28.01.11 deri me:	Derogimi i datës 30.08.11 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit Publik	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	31 dhjetor 2011	

### Licenca për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike

Nr	Neni	Derogimi i datës 15.08.08 deri me:	Derogimi i datës 17.02.09 deri me:	Derogimi i datës 09.02.10 deri me:	Derogimi i datës 30.04.10 deri me:	Derogimi i datës 10.09.10 deri me:	Derogimi i datës 28.01.11 deri me:	Derogimi i datës 30.08.11 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizim/tregtisë me energji elektrike	31 dhjetor 2008	31 mars 2009	31 mars 2010	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	31 dhjetor 2011	